

▶ PRANIMI I KOMUNITETIT MALAZEZ..... 2

▶ NJË LIGJ I RI MBI ARSIMIN PARAUNIVERSITAR 2

▶ SIGURIMI I PËRFAQËSIMIT TË BARABARTË TË KOMUNITETEVE NË ORGANET PUBLIKE3

▶ NDËRTIMI I LAGJES SHUMETNIKE..... 3

▶ MBËSHTETJE PËR KOMUNAT E REJA..... 4

▶ ANTARËSIMI NË DEKADËN ROME.....4



Nr. 1 | Jan - Maj | 2010

Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelaria e Premijera – Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelaria za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

Fuqia në diversitet

EDICIONI I PARË I BULETINIT TË ZYRËS PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE

Zyra për Çështje të Komuniteteve ka kënaqësinë të fillojë buletin e saj të ri mujor

"Fuqia në diversitet" është buletini i ri informativ nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK). Edicioni i parë mbulon periudhën nga janari deri në maj të vitit 2010, por edicionet e ardhshme do të publikohen në baza mujore. Ky buletin u ofron lexuesve informacione mbi aktivitetet kryesore të ZÇK-së, si dhe për çështjet me interes të veçantë për komunitetet. Duke komunikuar aktivitetet tona, ZÇK synon të rritë transparencën e punës së saj, dhe po ashtu, mbase që është edhe më me rëndësi, të arrijë deri tek palët e tjera të cilët ndajnë objektiva të njëjta dhe të ndërtojnë partneritete të reja. Në fund, ZÇK beson se theksimi i çështjeve që lidhen me interesat e komuniteteve dhe demonstrimi i përkushtimit të Qeverisë së Kosovës për të integruar komunitetet do t'i kontribuojnë kultivimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në Kosovë.

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë
Rruga: Nëna Terezë p.n.

Tel: +381 /0/ 38 200 14 444
E-mail: zck-kpz@ks-gov.net

ZYRA PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE: ROLI DHE RËNDËSIA

Cili është mandati i ZÇK? Si funksionon Zyra dhe kush janë pjesëtarët e stafit?

ZÇK u themelua brenda Zyrës së Kryeministrit në shtator të vitit 2008 për të bashkërenduar çështjet e komuniteteve brenda punës së Qeverisë.

Zyra është e përkushtuar për mbrojtjen dhe kultivimin e të drejtave të komuniteteve. Duke shërbyer si një shtresë shtesë mbrojtëse, këto u mundësojnë pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetet dhe kulturat e tyre si dhe të gëzojnë të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara për të gjithë.

ZÇK angazhohet në katër fusha kryesore: zhvillimin dhe vlerësimin e politikave, bashkërendimin dhe monitorimin e jetësimit të politikave, vetëdijesimin për komunitetet dhe financimin e projekteve që adresojnë nevojat e komuniteteve.

Siç do të lexoni në artikujt në vazhdim, zyra jonë është plotësisht e angazhuar në procesin legjislativ dhe komentet mbi të gjitha ligjet që ndikojnë në komunitete. ZÇK po ashtu vlerëson politikat dhe legjislacionin në baza vjetore që bie në kategorinë e studimit të politikave. Si pjesë e punës sonë për vetëdijesim, Zyra për Çështje të Komuniteteve ka zhvilluar një uebfaqe interaktive dhe të lehtë për përdorim që përmban një seksion të informatave kushtuar pjesëtarëve të komunitetit (vizitoni uebfaqen e ZÇK: <http://www.kryeministriks.net/zck/>). Veç kësaj pune, ku është e kyçur drejtpërdrejtë, ZÇK po ashtu financon disa nisma të implementuara nga OJQ ose komuna që synojnë integrimin e mëtejshëm të komuniteteve në shoqëri.

Stafi

Zyra për Çështje të Komuniteteve përbëhet nga katër pjesëtarë të stafit, secili që mbulon një aktivitet specifik, dhe udhëhiqet nga Srdjan Sentic – i cili është drejtor i zyrës dhe këshilltar i lartë i kryeministrit për komunitete. Safete Greiçevci, zyrtare e lartë për koordinim dhe grante, siguron se prioritetet e financimit të ZÇK të përmbushen dhe të respektohen procedurat. Njomza Krasniqi mban postin si zyrtare e lartë për informim publik dhe është përgjegjëse për të gjitha komunikimet e jashtme të ZÇK. Ekipi plotësohet me Ardijana Mulajn, e cila, si zyrtare administrative, siguron mbarëvajtjen e funksionimit të Zyrës. ZÇK po ashtu mbështetet nga një konsulente nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Minoriteteve (ECMI), Gaëlle Cornuz, si këshilltare mbi aktivitetet që ndërlihen me politika.

PRANIMI I KOMUNITETIT MALAZEZ

Qeveria e Kosovës është duke ndryshuar Ligjin për Komunitete për të përfshirë zyrtarisht malazezët si komunitet



SIGURIMI I BAZËS LIGJORE PËR ZYRAT KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE ZYRTARËT PËR KTHIM

ZÇK merr pjesë në Grupin Punues të ngarkuar me hartimin e një Rregulloreje mbi Zyrat e reja Komunale për Komunitete dhe Kthim



ZÇK i konsideron Zyrat Komunale për Komunitete (ZKK) dhe Zyrtarët për Kthim (ZK) si lidhje kyçe mes institucioneve të nivelit qendror dhe lokal si dhe me qytetarët. Ato po ashtu luajnë një rol thelbësor në jetësimin e shumë strategjive qeveritare që adresojnë shqetësimet e komuniteteve dhe si të tilla janë faktorë jashtëzakonisht të rëndësishëm në procesin e kthimit dhe do të bëhen faktorë përherë e më të angazhuar në ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

Disa raporte kanë alarmuar institucionet e Kosovës për statusin aktual të brishtë të këtyre strukturave komunale, të cilat, duke mos u paraparë nga Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, mbesin pa një mandat të qartë. Hulumtimi i kryer nga Njësia Mbështetëse për Koordinimin e Kthimit (SURC), brenda Zyrës së Zëvendëskryeministrit Manaj, dhe i financuar nga UNHCR nxori në pah

se këto struktura kanë nevojë të reformohen dhe të pranojnë mbështetje shtesë nga vetë komunitat, si dhe nga institucionet e nivelit qendror, me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre me efikasitet.

Andaj ZÇK bashkë-financoi dhe mori pjesë në një takim pune të mbajtur në Durrës nga 6 deri me 9 prill 2010, të organizuar nga Zyra Ligjore e KM dhe SURC, me qëllim të arritjes së një rregulloreje e cila do të zgjidhte këto çështje. Takimi i punës u ofroi palëve me interes, si Ministrisë për Komunitete dhe Kthim si dhe ZKK dhe ZK mundësinë për të formësuar mandatin dhe strukturën e Zyrave të reja Komunale për Komunitete dhe Kthim. Rregullorja do të udhëzojë komunitat për themelimin dhe fuqizimin e këtyre strukturave dhe së shpejti do të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

Me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, Qeveria ka filluar ndryshimin e Ligjit mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre (Ligji për Komunitete). Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK), në të cilin komuniteti malazez është përfaqësuar që nga shkurti i vitit 2009 dhe i cili po ashtu ka themeluar një grup punues për njohjen e këtij komuniteti, i ka kontribuar me të madhe këtij vendimi.

ZÇK ka marrë pjesë në grupin e ngarkuar me ndryshimin e Ligjit, të udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit. Ndonëse projekt amendamenti i fundit nuk është përfunduar ende, është paraparë që komuniteti malazez të njihet shprehimisht në nenin 1.4 dhe t'i sigurohen dy ulëse në KKK.

Një Ligj i ri mbi arsimin parauniversitar

ZÇK siguron se zhvillimi i kornizës ligjore respekton dhe kultivon të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si pjesë e procesit të reformimit të sistemit arsimor, ka hartuar një ligj të ri i cili do të rregullojë arsimin parauniversitar.

Arsimi është i rëndësishëm jetike për komunitetet, me që jo vetëm që përbën një forcë shtytëse për zhvillimin e brezave të rinj, por po ashtu luan një rol kryesor në ruajtjen dhe kultivimin e mëtejshëm të identiteteve të komuniteteve. Po ashtu luan një rol kyç në sigurimin e qasjes së barabartë në punësim dhe mundësi sociale. Andaj ZÇK e konsideron Ligjin e ri mbi Arsimin Parauniversitar si të rëndësishëm parësor për komunitetet dhe, duke ofruar komente në fazën e ndryshme të procesit hartues, synonte të garantojë se dispozitat e Kushtetutës, Ligji mbi Mbrojtjen dhe Kultivimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre dhe ligjet e tjera relevante, merreshin në konsideratë dhe fuqizoheshin nga ky Ligj.



ZÇK ka insistuar në nevojën për të përfshirë dispozitat mbi gjuhën e mësimdhënies – e cila duhet, në nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm, të ofrohet në të gjitha gjuhët – përfshirë edhe

lehtësimin e qasjes në arsim në gjuhën e dëshiruar duke ofruar transport pa pagesë. Veç kësaj, ZÇK është angazhuar në mbrojtje të nevojës për të përfshirë pjesëtarët e komuniteteve në organet vendimmarrëse dhe po ashtu në personelin e shkollës. Kjo do të garantojë se komunitetet do të ushtrojnë ndikimin e tyre dhe po ashtu do të sigurojnë se arsimi i ofruar do të adresojë nevojat e veçanta të nxënësve nga radhët e komuniteteve.

Për më shumë informacione vizitoni: <http://kryeministri-ks.net/zck/?page=2,107#?section>

SIGURIMI I PËRFAQËSIMIT TË BARABARTË TË KOMUNITETEVE NË ORGANET PUBLIKE



Publikim i Studimit të parë të Politikave të ZÇK

Në mars të vitit 2010, ZÇK publikoi Studimin e saj të parë të Politikave të kryer në vitin 2009 dhe të mbështetur nga një projekt i Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës. Studimi u përqendrua në çështjen e rëndësishme të punësimit të komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në ndërmarrjet publike.

Studimi jo vetëm që synonte ofrimin e një pasqyre të qartë të përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në të gjitha nivelet por po ashtu të konstatonte nivelin e jetësimit të kornizës ligjore që rregullon këtë çështje.

Të gjeturat nxorën në shesh se përfaqësimi i komuniteteve nuk mund të cilësohet si i barabartë në tërë spektrin institucional dhe nivelet hierarkike dhe po ashtu se legjislacioni relevant ekzistues është jetësuar vetëm në mënyrë të pjesshme.

Rekomandimet e miratuara nga Kryeministri përfshijnë masat me qëllim të zbatimit të ligjit si dhe një varg të masave novatore, siç janë imponimi i kuotave dhe shfrytëzimi sistematik i një rrjeti të institucioneve dhe OJQ-ve si instrumente shtesë për komunikim me komunitetet. ZÇK tashmë përqendrohet në jetësimin e këtyre rekomandimeve.

Për më shumë informacione dhe për tekstin e plotë të studimit vizitoni:

<http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=1,121>

FINANCIMI I NISMAVE PËR PËRMIRËSIM TË JETËSËS SË KOMUNITETEVE

ZÇK financon projekte të OJQ-ve dhe komunave të cilat mbështesin infrastrukturën, kultivojnë tolerancën, promovojnë kulturën dhe rrisin qasjen në punësim dhe arsim



Ndërtimi i Lagjes Shumetnike

Ndërtimi i 29 shtëpive në Novobërdë

Projekti “Novobërda shumetnike” është një shembull i qartë i përpjekjeve të Qeverisë për stabilizim të komuniteteve. Nga ky projekt strehimi social, i bashkë-financuar nga ZÇK, përfitojnë 29 familje në gjendje të rëndë sociale, të përkatësisë shqiptare, rome dhe serbe. Shpresohet se sigurimi i kushteve të dinjitetshme për jetesë për këto familje do të ketë efekte përcjellëse pozitive në aspektet e tjera të jetës së tyre, siç janë shëndeti dhe punësimi. Pjesa kryesore e punës tashmë është kryer dhe besohet që çelësat do t’u dorëzohen përfutësve në qershor të vitit 2010.



Shtëpi të reja për familjet që jetojnë në rrethana të vështira shoqërore

ZÇK financon ndërtimin e shtëpive për tri familje të komuniteteve jo-shumicë në Podujevë, Graçanicë dhe ferizaj

Një ndër qëllimet kryesore të ZÇK-së është edhe zgjidhja e problemit të banimit për familjet që nuk kanë kulm mbi kokë. Në vitin 2010, ZÇK ka zgjidhur problemin e banimit për tri familje të komuniteteve jo-shumicë (një familje serbe, një rome dhe një egjiptase) që jetonin në kushte tejet të vështira ekonomike dhe sociale. Implementimi i këtyre projekteve është bërë si rrjedhojë e parashtrimit të kërkesës nga ana e këtyre familjeve dhe është duke u realizuar përmes partnerëve me të cilët ZÇK ka marrëveshje mirëkuptimi. Projektet janë në fazën përfundimtare dhe familjet së shpejti do të këto shtëp të sapo-ndërtuara.

Përmirësimi i arsimimit parashkollor

Fillon ndërtimi i një kopshti fëmijësh në Llapnasellë, projekt i bashkë-financuar nga ZÇK

Pas një vlerësimi të kryer në vitin 2009 me mbështetje financiare nga ZÇK, projekti i ndërtimit të një kopshti të ri fëmijësh në Llapnasellë filloi në mars të vitit 2010. Ky projekt do t’i kontribuojë rritjes së cilësisë së arsimit si dhe rritjes së nivelit të shërbimeve financiare.



Krijimi i mundësive që komunitetet të qeverisin me veten: mbështetje për komunat e reja

ZÇK financon zhvillimin e komunave të sapokrijuara

Mbështetja e zhvillimit të komunave të sapokrijuara është prioritet kyç i Zyrës për Çështje të Komuniteteve me që komunat të cilat janë plotësisht operacionale dhe të cilat menaxhohen në mënyrë efikase janë jetike për komunitetet jo-shumicë.

Krijimi i komunave të reja, që lidhen me procesin e decentralizimit të pushtetit, u ofron komuniteteve mundësinë që drejtpërsëdrejti të qeverisin me çështjet dhe punët e rëndësishme kyçe, siç janë strehimi social, arsimi, shëndetësia, aktivitetet kulturore e ngjashëm.

ZÇK siguron asistencë financiare për komunat e sapokrijuara në jetësimin e projekteve, bazuar në Memorandume të Mirëkuptimit të nënshkruara mes ZÇK dhe komunave si dhe me partnerë të tjerë, përfshirë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

Deri më sot, ZÇK ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me komunat e Graçanicës dhe të Ranillugut.

Për më shumë informacione ju lusim të klikoni në: <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=1,4,28> dhe <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=1,4,21>



Antarësimi në Dekadën e Rome

Një delegacion i Qeverisë së Kosovës vizitoi Sekretariatit e Dekadës në Budapest dhe hodhi hapat e parë drejt antarësimit



Me nismë të ZÇK, një delegacion qeveritar, i udhëhequr nga Ministri për Komunitete dhe Kthim, Sasa Rasic dhe në përbërje të drejtorëve të Zyrës për Çështje të Komuniteteve dhe Qeverisje të Mirë, respektivisht Srdjan Sentic dhe Habit Hajredini, udhëtuan në Budapest për të hulumtuar mundësinë e antarësimit të Kosovës në Dekadë.

Delegacioni u takua me Ministrin Hungarez për Mirëqenie Sociale, László Herczog dhe mori mbështetjen e tij, pastaj me përfaqësues nga Instituti për Shoqëri të Hapur si dhe me Sekretariatit për Koordinim të Përfshirjes në Dekadën Rome. Të gjithë u zotuan për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës në përpjekjet e saj për të mbështetur të drejtat e komuniteteve romë, ashkalinje dhe egjiptiane. Kosova pritet që zyrtarisht të parashtojë aplikacionin e saj për antarësim në Dekadë në shtator të këtij viti.

Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të Romëve

Me 8 prill 2010, në Ditën Ndërkombëtare Rome, Qeveria e Kosovës organizon një konferencë ceremoniale dhe financon disa manifestime nëpër Kosovë

Dita Ndërkombëtare Rome shënon Kongresin e parë Ndërkombëtar Rom të mbajtur në vitin 1971, në të cilin përfaqësuesit e komunitetit rom u mbledhën së bashku kundër diskriminimit me të cilin përballej komuniteti i tyre në mbarë Evropën.

Në vitin 2010, për të dytin vit me radhë, ZÇK organizoi një konferencë ceremoniale në të cilën Kryeministri, Përfaqësuesi Special i BE-së – Pieter Feith dhe përfaqësues të komunitetit rom, institucioneve kosovare, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile shënuan këtë ditë të rëndësishme.

ZÇK po ashtu financon edhe ngjarje të tjera, që nga ekspozitat kulturore deri te turnetë e futbollit, të përzgjedhura përmes ftesave për propozime, të cilat u mbajtën në Berivojcë, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Prelluzhë, Prishtinë dhe Prizren. Në Prishtinë, festivali “Bahtalo!” mbledhi së bashku rreth 1000 persona nga të gjitha komunitetet, të cilët, mes festimeve të tjera, po ashtu u qerasën edhe me një koncert nga këngëtarja e mirënjohur maqedonase Esmë Redzepova.

